



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



KUVENDI I KOMUNËS

KOMITETI PËR KOMUNITETE

EKSTRAKT

nga procesverbali i mbajtur më 10 shtator 2020, në mbledhjen e XXVI-të (njëzet e gjashtë) të Komitetit për Komunitete, mandati VI.

Mbledhja u mbajt në sallën e mbledhjeve të Kuvendit, ndërtesa e re e Komunës, dhe filloi në orën 10;10.

Mbledhjen e hapi dhe kryesoi Albina Avdiu Kryesuese e Komitetit,

Fillimisht u vërtetua se në mbledhje ishin të pranishëm anëtarët e këtij Komiteti dhe atë: Valbona Kadriu-Podvorica, Benjamin Ejupi, Bashkim Sylja, Doruntina Hasani, ndërsa munguan Valmire Lahu, Mefail Rama dhe Radisav Perović.

Me këtë u konstatua se ekziston kuorumi për punë.

Në mbledhje të pranishëm ishin, Zaim Thaçi, drejtor i Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale – DSHMS, Liman Zeqiri, shef i Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim-ZKKK, Fadil Babatinca nga Stacioni i Policisë në Podujevë, Xhevat Llugaliu, zyrtar nga Drejtoria e Arsimit në Komunën e Podujevës.

Rendi i ditës

znj. Albina Avdiu, Kryesuese e Komitetit, e hapi mbledhjen duke iu uruar mirëseardhje të pranishmëve, ndër të tjera theksoi, besoj që janë plotësuar kushtet për fillimin e mbledhjes, materialin e keni marrë me kohë dhe jeni në njohuri për pikat e rendit të ditës. Nëse ndokush ka diçka për të shtuar urdhëroni nëse jo atëherë e hedhë në votim këtë pikë të rendit të ditës.

Njëzëri u miratua rendi i propozuar i ditës sipas thirrjes dhe materialit përkatës.

- 1. Ekstraktet e procesverbaleve nga mbledhjet e Komitetit për Komunitete, të mbajtura më: 10 korrik 2020 dhe 05 gusht 2020**

Njëzëri u miratuan Ekstraktet e procesverbaleve sipas kësaj pike

- 2. Informatë lidhur me gjendjen e krijuar nga pandemia Covid 19 në Komunën e Podujevës**

z. Zaim Thaçi, drejtor i DSHMS, theksoi, situata epidemiologjike në Komunën e Podujevës është situatë që menaxhohet aktivitetet po vazhdojnë në dy komponente që nënkupton shtrirja e aktiviteteve në komponentin shëndetësor dhe në komponentin social. Në komponentin shëndetësor jemi duke punuar në ekupe përveç mjekëve familjar të cilët janë të angazhuar ditëve të fundit sipas udhëzimeve dhe rekomandimet të IKSHPK-së, të gjithë mjekët familjarë dhe i gjithë personeli shëndetësor do të kontribuojë drejtpërdrejtë te pacientët e dyshuar dhe te

pacientët me Covid 19. Vazhdon shërbimi i veçantë i quajtur anti Covid 19, i cili ofron shërbime 24 orë pacientëve të dyshuar me Covid 19 të cilët trajtohen në ambientet e QKMF-së dhe pacientëve të cilët janë me sëmundje të ndryshme të cilët trajtohen në shtëpitë e tyre.

Vështirësitë janë evidente por mund të themi që kemi krijuar një përvojë të mirë gjatë këtyre muajve që jemi në pandemi e që situatën epidemiologjike në Komunën tonë jemi duke menaxhuar mirë. Materialet mbrojtëse uniformat, maskat, dorezat, dezinfektuesit janë në sasi të mjaftueshme dhe janë shpërndarë në të gjitha institucionet shëndetësore. Gjithmonë ekziston tendenca që me pasë rezerva dhe fonde të reja ndërsa ne mund të themi që jemi në një situatë të mirë. Një komponent tjetër që jemi marrë me të dhe që është pjesë e kampanjës anti Covid 19 është edhe dezinfektimi i hapësirave të banimit për një periudhë të caktuar ndërsa tani për prioritet kemi dezinfektimin e hapësirave shëndetësore në bazë të rekomandimeve që janë mirëpo dezinfektimet do të bëhen edhe më të shpeshta megjithatë ne jemi duke i bërë me një trend sipas rekomandimeve të Shërbimit Publik të Shëndetit në Komunën e Podujevës. Komponenti social jemi kryesisht të varur prej donatorëve sepse gjatë fazës emergjente kur familjet ishin të izoluar e që e kemi kaluar atë fazë mirëpo prapë kemi raste sporadike të cilat kanë nevojë për një ndihmë në kuptimin e ofrimit të një pakoje ushqimore dhe higjienike. Kemi një fond që nuk mjafton për me i përfshi të gjitha ato raste që kanë nevojë por për rastet të cilat janë të domosdoshme kemi fond. Sot një familje në fshatin Tërnavë ia ofruam një ndihmë të tillë, ky ishte një lloj informacioni përndryshe në qoftë se dikush nga ju ka ndonjë pyetje absolutisht ne jemi të gatshëm të përgjigjemi.

znj. Albina Avdiu, Kryesuese e Komitetit, pyetje për parafolësin, a ka pasë pacient të infektuar nga komuniteti Rom, Ashkali dhe Egjiptas, ose persona nga komuniteti që janë testuar për Covid 19, si dhe a është bërë dezinfektimi i hapësirave në komunitet apo a ka pasë ndonjë kërkesë të tillë nga Komuniteti Rom, Ashkali dhe Egjiptas.

z. Zaim Thaçi, drejtor i DSHMS, sqarime parafolëses, situata epidemiologjike në Komunën tonë por në përgjithësi edhe në Kosovë është marrë si tërësi. Ne kemi raportet për testimet për rastet të cilat vijnë si raste pozitive që janë testuar në Komunën tonë e që janë qytetarët e Komunës së Podujevës ku për të gjithë pacientët e trajtuar nuk ceket nacionaliteti apo përkatësia e tyre kombëtare etnike etj, që do të thotë se ata janë qytetarë të barabartë që kanë identitet emër dhe mbiemër dhe numër kontaktues që shërbimi i shëndetit publik me specialistët e fushës që merren me trajtimin e tyre, dhe informacione kemi prej momentit kur pacienti testohet deri në marrjen e rezultatit për ndryshe unë e di që ka qenë një kërkesë prej komunitetit që të iu dezinfektohet një hapësirë e banimit. Unë mendoj që është dezinfektuar ajo hapësirë e banimit por absolutisht kudo që ka ekzistuar ndonjë kërkesë dhe kudo që ekziston ndonjë kërkesë e tillë ne do bëjmë dezinfektimin. Gjatë ditës së djeshme bëmë një dezinfektim të një hapësire në fshatin Herticë, fjala është për një kërkesë të një qytetari, mirëpo ne nuk bëjmë dallime mes kombësive e aq më pak në situata epidemiologjike. Nuk jemi lëshuar në masën e studimit mirëpo unë para disa ditësh kuptova nga qytetarët rreth një studimi për personat të cilët kanë një grup të caktuar të gjakut siç është grupi i gjakut A-pozitiv janë më pak të prekur me Covid 19 kurse grupet tjera të gjakut janë më shumë të prekura me Covid 19, unë mendoj që ky studim i takon një forumi tjetër për ndryshe ne i trajtojmë qytetarët dhe mundohemi dhe duhet ti trajtojmë qytetarët të barabartë në situata epidemiologjike. Sa herë ata kanë nevojë për testim sa herë ata kanë nevojë për një mbështetje institucionale ne do të mundohemi dhe e kemi obligim që të i'u përgjigjemi, për ndryshe këto janë të gjitha informacionet. Deri më datën 09.09.2020, kanë qenë 470 pacient të shëruar ndërsa 81 raste aktive me Covid 19 prej këtyre rasteve nuri i pacientëve të testuar në komunën tonë është me mijëra nuk e kemi numrin e saktë nuk e di ndoshta janë 4000 ose 5000,

pacient të testuar, nuk e kam shifrën e saktë ndërsa raste aktive me Covid 19 janë 81 pacient e që gjendja e tyre shëndetësore është e mirë.

z.Bashkim Sylaj, theksoi, lista e pritjes për testim është e gjatë, më herët e dimë që ka pasë probleme për pacientët të cilët janë lajmëruar për testim deri në tri ose katër ditë për tu testuar, desha të di se a ka ndryshuar kjo formë e testimit kur e dimë se në kohën e fundit ka zbritur numri i të infektuarave me Covid 19, andaj pyetja ime është se a ka ndryshime në listën e pritjes për testim, kur pritjet të filloj viti i ri shkollor dhe a ka kërkesa për dezinfektimin e objekteve shkollore, a keni marrë ndonjë kërkesë nga Drejtoria e Arsimit për testim të mësimdhënësve.

z.Zaim Thaçi, drejtor i DSHMS, sqarime para folësit ne jemi duke bërë teste të shpejta jo teste serologjike që do të thotë se për këtë sëmundje është e rëndësishme që diagnostikimi dhe përqindja e rezultateve të ketë besueshmëri dhe besueshmëria është te testet RTPCR, për të cilin test mostrat merren në Komunën e Podujevës, kurse për teste të shpejta që kemi laborator në Podujevë dhe laboratorë tjerë që janë të licencuara në Prishtinë, testet janë të shpejta por besueshmëria e tyre është më e vogël. Ne në institucionin publik shëndetësor i marrim mostrat ndërsa përpunimi i tyre bëhet në IKSHPK. Kapacitetet të cilat i kanë në IKSHPK janë po thuajse të njëjta me kapacitetet që kanë qenë nga fillimi i pandemisë, aparatura, personeli, sigurisht janë konsoliduar pakëz por nuk kemi informacione që testimet kryhen në dy ose tri vende. Testimet prapë vazhdojnë në të njëjtin vend por lista e pritjeve në rrethana të caktuara ka qenë kur ka pasë ndonjë mbi ngarkesë kur për një moment nga e gjithë Kosova janë dërguar të gjitha mostrat në të njëjtin vend për ndryshe lista e pritjes nuk është e gjatë. Shqetësuese është fakti kur kërkohet testimi RTPCR nga qytetarët për udhëtim jashtë vendi e që janë studentë, pacientë për trajtim në Maqedoni e që atyre ju duhet ky test kurse ne testet RTPCR ju ofrojmë vetëm pacientëve të cilët kanë shenja klinike të sëmundjes dhe ajo tyre që dëshirojnë të udhëtojnë, madje kemi pasë kërkesa për testim edhe nga qytetarë për me kalua pushimet në bregdet në Ulqin ne nuk kemi mundësi për ofrimin e testeve sepse rekomandimet e IKSHPK-së janë që teste të i'u ofrojmë pacientëve të cilët kanë simptoma të sëmundjes dhe jo atyre që dëshirojnë të testohen pa shenja klinike të sëmundjes. Laboratorët e licencuara janë në Prishtinë ku për momentin janë tri laboratorë që ofrojnë shërbime të tilla, ndërsa për testet e shpejta ekziston besueshmëria më e vogël sepse është test që kryhet shpejt në një formë shpjegimi i atij testi për profesionistët është që a ka krijuar pacienti anti gjene anti korpe për atë sëmundje d.m.th. a është i sëmur tani apo a ka qenë i sëmur më parë me këtë sëmundje por besueshmëria e tyre është më e vogël.

Lidhur me informacionet për fillimin e vitit shkollor kam informacion që Ministria e Shëndetësisë është duke përgatit një raport të detajuar për shkollat lidhur me plotësimin e kushteve për fillimin e vitit të ri shkollor sigurisht Drejtoria e Arsimit e ka intensifikuar përgatitjen për fillimin e vitit të ri shkollor.

3. Informatë lidhur me përgatitjet e fillimit vitit të ri shkollor 2020-2021 dhe sfidat e nxënësve të komuniteteve jo shumicë

z.Xhevat Llugaliu, zyrtar nga Drejtoria e Arsimit, theksoi, mësimi në të gjitha institucionet edukativo arsimore pritjet të filloj të hënën më datë 14 shtator 2020, DKA ka bërë gjitha përgatitjet e nevojshme për fillimin e mësimi, kemi dezinfektuar të gjitha objektet shkollore. Më 29 gusht 2020 është mbajtur testi i maturës ku këtij testi ju kanë nënshtruar 1115 maturant, ky test është mbajtur në 8 qendra dhe nuk ka pasë probleme procesi është zhvilluar ashtu siç është më së miri. Jemi pajisur me broshurat e Ministrisë së Arsimit dhe IKSHPK-së, presim sot që ti marrim 100 termometra për matjen e temperaturës, ku këta termometër do të shpërndahen nëpër shkolla

varësisht numrit të nxënësve. Ne kemi rreth 37 shkolla fillore, 3 shkolla të mesme dhe 1 çerdhe por kemi edhe shkolla të ndara në paralele mirëpo edhe aty ne do të sigurojmë nga një termometër. Dezinfektues kemi siguruar për çdo shkollë dhe jemi duke përgatitur plan programet se si do vazhdojmë tutje se në cilin variant do shkojmë, nëpër shkollat që kanë numër më të vogël do të shkojmë me variantin 1 siç e dha Ministria e Arsimit me datë 14 dhe 21 shtator. Drejtori është duke përgatitur plan programe për fillimin e vitit të ri shkollor për shkollat në qytet të cilat kanë numër më të madh të nxënësve, presim që të jetë një fillim vit i mbarë dhe i mirë për të gjithë nxënësit pas 6 muajve që nxënësit janë jashtë bankave shkollore. Për pajisjen e Komunitetit jo shumicë do ta shikojmë situatën sepse kësaj radhe jemi më të përgatitur sepse qeveria ka nda mjete më shumë nëse paraqitet nevoja për mbajtjen e mësimin në distancë ne do i shikojmë mundësitë që të iu sigurojmë të gjithë nxënësve që nuk i kanë mundësitë nga një pajisje qoftë llaptop apo ipad pa dallime të përkatësisë kombëtare. Fillimi i vitit shkollor pritet të fillojë ashtu siç e ka caktuar MASHT me 14 dhe 21 shtator 2020.

znj. Albina Avdiu, Kryesuese e Komitetit, pyetje për parafolësin pas anulimit të mbajtjes së testit të maturës kur dihet se nxënësit e komunitetit nuk kanë sukses të mirë desha të di se a keni ndonjë informatë sa nxënës nga radhët e Komunitetit jo shumicë janë regjistruar në shkollat e mesme.

z. Xhevat Llugaliu, zyrtar nga Drejtoria e Arsimit, theksoi, sqarime parafolëses, është hera e parë që për shkaqe të pandemisë nuk realizohet testi i arritshmërisë, po të ishte realizuar testi i arritshmërisë do e kishim një pasqyrë më të qartë por megjithatë MASHT nuk ka ndej duar kryq e ka bërë një poen tim apo rangim dhe ne e kemi shpallur konkursin ju kemi përmbajtur atij poentimi. Vend për regjistrim ka për të gjithë nxënësit ata nxënës që kanë qenë të shkëlqyer kanë shkuar në gjimnaz dhe në mjekësi në shkollën ekonomike është plotësuar numri kurse vende të lira për nxënësit e pa regjistruar ka në shkollën teknike që janë edhe 150 vende të lira. Ne nuk mund ta dërgojmë një nxënës qoftë i komunitetit shumicë apo pakicë nëse nuk e ka suksesin e shkëlqyer në gjimnaz, vende të lira ka por numri i nxënësve sa kanë mbet pa u regjistruar varion diku rreth 150 nxënës që dokumentacionet nuk i kanë dorëzuar ose që kanë shkuar në gjimnaz e nuk iu kanë pranuar dokumentacioni sepse nuk kanë pasë sukses të shkëlqyer për ata nxënës varianti ka qenë shkolla ekonomike ose teknike dhe ata nxënës ne nuk do i lëmë jashtë bankave shkollore sepse vend ka për të gjithë por me sukses të mjaftueshëm nuk mundesh me zgjedh se në cilën shkollë dëshiron të regjistrohesh.

z. Liman Zeqiri, shef i ZKKK, theksoi, sipas informacioneve që kam janë bërë përgatitje për fillimin e vitit të ri shkollor, është bërë dezinfektimi i të gjitha objekteve shkollore dhe furnizimi me dezinfektues dhe maska nga IKSHPK. Gjatë datës 27 dhe 28 gusht 2020 janë mbajt fushata për vetëdijesimin e nxënësve Rom Ashkali dhe Egjiptas kjo është tema më shumë për komunitetet pakicë ky aktivitet është financuar nga GIZ në bashkëpunim dhe implementim me Komunën e Podujevës dhe Qendrën e Arsimit të Kosovës. Në këtë fushatë kanë marrë pjesë tutorët e qendrave mësimore zyrtarë nga DKA, Qendra e Arsimit të Kosovës dhe Drejtorët e Shkollave dhe Drejtorët kompetentë. Gjatë kësaj jave janë duke u shpërnda libra nëpër të gjitha shkollat e Komunës së Podujevës dhe po bëhen përgatitjet e nevojshme për fillimin e vitit të ri shkollor 2020/2021, duke falënderuar GIZ-in, DKA-në, Komunën, Qendrat e Arsimit të Kosovës, Drejtorët e Drejtorive dhe Drejtorët e Shkollave de-fakto është përgatitje maksimale e të gjitha objekteve dhe pajisjeve teknike dhe librave për të gjitha shkollat që të filloj procesi i ri mësimor në kushte normale.

znj. Albina Avdiu, Kryesuese e Komitetit, kam një kërkesë drejtuar ju z. Liman Zeqiri lidhur me një nxënës të Komunitetit Ashkali, fjala është për nxënësin Florent Bajrami i cili nuk ka mundur të regjistrohet në shkollën e mesme në drejtimin e Infermierisë dhe pyetja ime konkrete është se a ka mundësi që ky nxënës të regjistrohet në drejtimin e infermierisë.

z.Xhevat Llugaliu, sqarime parafolëses, ne këtë vit shkollor i kemi shpallë konkurs për dy drejtime të mjekësisë, dy klasë njëra ka qenë infermieri kurse klasa tjetër farmaci numri i nxënësve ka qenë i caktuar 26 nxënës për një klasë. Konkurrenca më e madhe ka qenë në drejtimin e infermierisë aty kanë aplikuar rreth 80 nxënës dhe prej 80 dokumentacione të dorëzuar janë pranuar 35 dokumentacione që kanë qenë me numër maksimal të pikëve 100 dhe ata nxënës me numër maksimum të pikëve është dashur të i fusim në testim edhe një herë ku prej 35 nxënësve 26 janë regjistruar kurse 9 nxënës janë refuzuar që kanë pasë maksimumin e pikëve 100, kurse tani ju për këtë rastin që pyetët unë nuk e di se çfarë nxënësi ka qenë ai dhe a ka hy në test ai nxënës dhe çfarë rezultati ka pasë, nëse ky nxënësi në fjalë nuk ka hy në test nënkupton se nuk i ka pasë 100 pikë dhe nuk ka mundur të regjistrohet. Ne përzgjedhjen e nxënësve nuk e kemi bërë dhe nuk e bëjmë në bazë të përkatësisë kombëtare apo etnike por në bazë të poentimit ku në këto dy drejtime janë 50 ose 60 palë dokumentacione që janë refuzuar e të gjithë ata nxënës kanë qenë nxënës shembullor.

1. Të ndryshme

Nuk pati diskutime.

Kryesuesja e Komitetit e konstatoj të përfunduar këtë mbledhje.

Mbledhja përfundoi në orën 10:35

**Procesverbalin e mbajti
Osmon Bajrami**

**Nr. 01-060/04-0054390/20
Podujevë,
10 shtator 2020**

**Kryesuese e Komitetit
Albina Avdiu**